



B029
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË RAST
FATKEQËSIE
ZNJ. LUMTURI YZI**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Z. Muhamet Yzi me nr. 1430 prot, datë 16.03.2022, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.94, datë 28.12.2021 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë !

Familja Yzi është familje që i përket komunitetit egjiptian e cila jeton në lagjen nr.3 “Donika Kastrioti” e përbërë nga 4-anëtar. Z. Halim, znj.Lumturi dhe dy djemt Erjon dhe Muhamet Yzi.

Prej vitesh familja Yzi është mbështetur nga drejtorja e Shërbimit Social me shërbime konkrete si: ndihmën ekonomike, mundësin e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar, paketa ushqimore/higjenosanitare si dhe është referuar në projekte të ndryshme si familje në vështirësi të theksuar social-ekonomike.

Situatë e familjes Yzi përgjat kohës që është mbështetur nga strukturat e Shërbimeve Sociale ndryshojë pak, pasi djemt e kësaj familje e kishin tepër të vështirë dhe të pa mundur të integroheshin në tregun aktual të punës, që ofron qyteti Beratit. Ata janë të pa arsimuar dhe nuk kanë një profesion, e vetmja mënyrë për të mbijetuar dhe për të gjeneruar të ardhura është mbledhja e mbetjeve të riciklueshme në depozitimet e mbeturinave të qytetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për të mos mjaftuar vështirësive social-ekonomike që shkojnë në kufijt e varfërisë të tejskajshme, familja Yzi në vitin 2021 përballlet dhe me problemet shëndetësore të znj. Lumturi Yzi, e cila pëson ishemi dhe kalonë në koma cerebrale. Për 6-muaj znj. Lumturi luftojë me sëmundjen pasi mbeti e paralizuar dhe çdo ditë përkeqësoheshe, deri në datë 08.03.2022 ku ajo ndërroj jetë.

Familja Yzi e mbështetur edhe nga OJF-të lokale kontaktojë me drejtorinë e Shërbimit Social pasi e kishte të pa mundur të paguante shpenzimet mortore si dhe nuk kishte asnjë ambjent të përshtatshëm për të pritur të afërmit.

Menjëherë pasi na është referuar rasti si dhe djali i familjes Yzi z. Muhamet Yzi kontaktojë drejtëpërdrejt me ne, u morëm të gjitha masat për të trajtuar rastin. Përgjatë vizitës që realizua në banesë konstatojmë që familja Yzi ka vështirësi të theksuara social-ekonomike dhe kushte shumë të vështira jetese. Ata jetojnë në një banesë të tipologjisë një dhomë dhe në kushte jashtëzakonisht të vështira. Të vetmet t ardhura që ka familja vijnë nga mbledhja e mbetjeve të riciklueshme në depozitimet e mbeturinave të qytetit dhe pagesa e aftësisë së kufizuar që merte e ndjera znj. Lumturi Yzi.

Për sa më sipër duke parë të ardhurat që ka familja, kushteve në të cilat jetojnë, situatën social-ekonomike, e kanë të pamundur të përballojë shpenzimet e varrimit në masën 40.000 lekë, propozojmë rimbursimin e shpenzimeve të varrimit.

(bashkëngjitur keni certifikatën e vdekjes/para dhe aktuale, vërtetimin e ndihmës ekonomike, kërkesën në zyrën me një ndalesë, foto nga banesa, faturën e shpenzimeve nga subjekti).

DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË RAST
FATKEQËSIE
ZNJ. NADIRE METANI**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Znj. Nadire Metani me nr. 399 prot, datë 04.03.2022, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.94, datë 28.12.2021 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë !

Familja Metani është familje që i përket komunitetit rom, e cila jeton në Nj.Adm Otlak, fshati “Moravë”, lagjja “Stan” e përbërë nga 6-anëtar. Znj. Nadire Metani është aktualisht K/familjare e familjes Metani (bashkëngjitur gjeni çertifikatën). Prej vitesh familja Metani është mbështetur nga drejtorja e Shërbimit Social me shërbime konkrete si: ndihmën ekonomike, mundësin e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar, paketa ushqimore/higjienosantare si dhe është referuar në projekte të ndryshme si familje në vështirësi të theksuar social-ekonomike.

Situatë e familjes Metani përgjat kohës që është mbështetur nga strukturat e Shërbimeve Sociale ndryshojë pak, pasi antarët madhor të kësaj familje e kishin tepër të vështirë dhe të pa mundur të integroheshin në tregun aktual të punës, që ofron Nj.Adm Otlak . Ata janë të pa arsimuar dhe nuk kanë një profesion, e vetmja mënyrë për të mbijetuar dhe për të gjeneruar të ardhura është mbledhja e mbetjeve të riciklueshme në depozitimet e mbeturinave të qytetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për të mos mjaftuar vështirësive social-ekonomike që shkojnë në kufijt e varfërisë të tejskajshme, familja Metani në vitin 2021 përballlet dhe me problemet shëndetësore të Z.Gëzim Metani i cila dignostikohet me sëmundje terminale. Për afro një vitë Z, Gëzim luftojë me sëmundjen dhe në datë 12.10.2021 ai ndërroj jetë për shkak të insuficiences kardio-respiratore.

Familja Metani e mbështetur nga Administratori i Nj.Adm Otlak dhe Administratori Shoqëror kontaktojë me drejtorinë e Shërbimit Social, pasi familja e kishte të pa mundur të paguante shpenzimet mortore .

Menjëherë pasi është referuar rasti si dhe kontaktit të drejtëpërdrejtë në zyrat tona, u morëm të gjitha masat për të trajtuar rastin si emergjent. Përgjatë vizitës që realizuam në banesë vëzhguam se familja prej 6-anëtarësh jetonte në një ndërtesë të amortizuar dhe me ambiente të pamjaftueshmë për anëtarët e familjes. Ata jetojnë në një banesë të tipologjisë 2(dy) dhoma dhe në mungesë të shtretërve dhe elektroshtëpiake. Në familje jeton dhe nipi, vetëm 7 vjec me aftësi ndryshe i cili ka nevoja të veçanta, të cilit i është ndërprerë pagesa e aftësisë së kufizuar dhe është dërguar ankesa për në KEMP-in Epror. Gjithashtu, familja ka vështirësi social-ekonomike dhe kushte shumë të vështira jetese për shkak të problemeve sociale prej vitesh. Të vetmet të ardhura që siguron familja janë nga mbledhja e mbetjeve të riciklueshme në depozitimet e mbeturinave të qytetit.

Për sa më sipër duke parë të ardhurat që ka familja, kushteve në të cilat jetojnë, situatën social-ekonomike, e kanë të pamundur të përballojë shpenzimet e varrimit në masën 40.000 lekë, propozojmë rimbursimin e shpenzimeve të varrimit.

(Bashkëngjitur keni certifikatën e vdekjes/ aktuale, vërtetimin e ndihmës ekonomike, kërkesën në zyrën me një ndalesë, foto nga banesa, faturën e shpenzimeve nga subjekti etj).

DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.36, DATË 22.05.2020 “ MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË
PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË SË BERATIT DHE TË PUNONJËSVE TË
NJËSIVE NË VARËSI TË SAJ “ I NDRYSHUAR**

Të nderuar Këshilltarë!

Me hyrjen në fuqi të VKM nr 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” , i cili ka shfuqizuar VKM nr 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, pësojnë ndryshime në nivelin e pagave punonjësit mbështetës të bashkisë dhe të njësive shpenzuese .

Nga ana jonë është parashikuar që efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2022, i miratuar në muajin dhjetor 2021.

Në këto kushte, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 64 gërma “ j VKM 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” VKB nr.36 datë 22.05.2020 “Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Berat dhe punonjësve të njësive shpenzuese në varësi të saj”, i ndryshuar me VKB nr 4 datë 31.01.2022, VKB nr.87 datë 18.12.2021 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, Vendimi i Kyetarit të Bashkisë nr.860 datë 20.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë dhe njësive shpenzuese për vitin 2021” i ndryshuar me Vendimin e Kyetarit të Bashkisë nr.268 datë 28.04.2022, ”VKB Nr . 94 date 29/12/2021 të Keshillit Bashkiak Berat “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024”,

Ju propozojmë të miratoni nivelin e pagave të punonjësve mbështetës sipas pasqyrave bashkëlidhur.

Ju faleminderit !

Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Gentian Dashi

Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
Rovena Shehu

Pasqyra 1.1 STRUKTURA NUMRI I PUNONJESVE, KATEGORITË DHE KLASAT E PAGËS APARAT

Nr.	Emertimi sipas strukturës	Nr. i punonjësve	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
1	DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE					
2	Punonjës për Parkimin dhe Tregjet	4	I mesëm	Klasa V	1%	34,500
	DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE					
3	Shofer	2	I mesëm/leje drejtimi	Klasa III	1%	33,400
4	Sanitare	5	I mesëm/8/9-vjeçare	Klasa I	1%	32,000
5	Roje	1	I mesëm/8/9-vjeçare	Klasa I	1%	32,000
	SEKTORI I PRONAVE DHE STREHIMIT					
6	Kujdestar i Banesave Sociale	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
	DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN, LEJEVE DHE MONITORIMIT TE INVESTIMEVE					
7	Topograf		I mesëm	Klasa V	1%	34,500

Pasqyra I.2 KLASAT E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË STRUKTURËN E

DREJTORISË SË ARSIMIT

Nr	Emertimi sipas struktures	Nr. i punonjësve	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
SEKTORI EKONOMIK						
1	Llogaritare	1	I mesëm /ekonomik	Klasa VIII	1%	36,000
2	Inventarizuese	2	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
3	Magazinier	1	I mesëm	Klasa IV	1%	34,100
SEKTORI TEKNIK DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE						
4	Marangoz	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
5	Punëtor dhe Bojaxhi	3	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
6	Hidraulik	2	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
7	Mirembajtes kanalizues	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
8	Elektriçist + elektromekanik	2	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
9	Shofer	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
10	Sanitare në Institucion	1	I mesëm. /8 vjeçar	Klasa I	1%	32,000
11	Sanitare të shkollave të Njesisë Administrative Otllak, Roshnik, Sinie	19	I mesëm. /8 vjeçar	Klasa I	1%	32,000
12	Roje shkolle në Njesinë Administrative Otllak.	4	I mesëm. /8 vjeçar	Klasa I	1%	32,000
SEKTORI I USHQIMIT PËR KOPËSHTET, ÇERDHET DHE KONVIKTIN E NXENESVE						
13	Kuzhinier	3	I mesëm profesional	Klasa V	1%	34,500
14	Ndihmes Kuzhinier	10	I mesëm	Klasa II	1%	32,700
15	Magazinier	1	I mesëm	Klasa IV	1%	34,100
16	Shofer	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400

KLASAT E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË ÇERDHEN NR.1,5,7 DHE UZNOVË

Nr.	Emertimi sipas struktures	Nr.punonjësve	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
1	Edukatore	28	I mesëm	Klasa V	1%	34,500
2	Sanitare	6	I mesëm /8 /9-vjeçar	Klasa I	1%	32,000
3	Rrobalarëse	3	I mesëm /8 /9-vjeçar	Klasa I	1%	32,000

KLASAT E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË KONVIKTET E SHKOLLAVE TË MESME						
Nr	Emertimi sipas struktures	Nr. i punonjësve	Arsimi	Klasa + Kateg.	Vjetërsia	Paga e grupit
1	Rrobaqepës	1	I mesëm	III	1%	33,400
2	Hidraulik	1	I mesëm	III	1%	33,400
3	Punonjës Mirëmbajtes	2	I mesëm	III	1%	33,400
4	Sanitare	3	I mesëm	I	1%	32,000
5	Roje nate pa armë	4	I mesëm	I	1%	32,000

PASQYRA I.3. KLASAT E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË STRUKTURËN E AGJENCISË SË SHERBIMEVE PUBLIKE						
Nr	Emertimi sipas struktures	Nr. i punonjësve	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
SEKTORI EKONOMIK						
1	Magaznier	2	I mesëm	Klasa IV	1%	34,100
SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE , NDRIÇIMIT PUBLIK DHE DEKORIT						
2	Teknik punimesh	1	I mesëm	Klasa V	1%	34,500
3	Punëtor mirembajtes	31	I mesëm/8-vjeçar	Klasa III	1%	33,400
4	Punëtor trotuari, Kalldremxhi	8	I mesëm/8-vjeçar	Klasa III	1%	33,400
5	Punëtor Asfaltimi	4	I mesëm/8-vjeçar	Klasa III	1%	33,400
6	Elektriçist për ndriçimin publik	6	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
SEKTORI I GJELBËRIMIT DHE PASTRIMIT						
7	Mirëmbajtës të Gjelberimit dekorativ	10	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
8	Krasitës , Kositës, Trapjantues	10	I mesëm	Klasa I	1%	32,000
9	Lulishtarë	24	I mesëm/8/9-vjeçar	Klasa I	1%	32,000
10	Punonjës për pastrimin e hapsirave të gjelbëruara	6	I mesëm/8/9-vjeçar	Klasa I	1%	32,000

SEKTORI MEKANIK DHE TRANSPORTIT						
11	Shofer Trasporti mbi 2.5 ton	4	I mesëm	Klasa VII	1%	35,400
12	Fadromist dhe Skrepist	1	I mesëm	Klasa VII	1%	35,400
13	Fadromist Mekanik	1	I mesëm	Klasa VII	1%	35,400
14	Shofer kamioni	1	I mesëm	Klasa VII	1%	35,400
15	Shofer Autokulle mbi 2.5 ton	1	I mesëm	Klasa VII	1%	35,400
16	Shofer transporti deri në 2.5 ton	3	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
17	Manovrator, Rrulist dhe Mekanik	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
SEKTORI I MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE						
18	Punëtor mirembajtjen e varezave publike në Niësite Administrative	4	I mesëm/8-vjeçar	Klasa III	1%	33,400
19	Roje nate për varrezat publike	6	8/9-vjeçar	Klasa e I	1%	32,000
20	Punëtor për hapjen e varreve (Varrmihës)	7	8/9-vjeçar	Klasa e I	1%	32,000
SHËRBIMET MBËSHTETËSE						
21	Sanitare në tregun industrial	2	8/9-vjeçar	Klasa e I	1%	32,000
22	Roje nate për Agjensinë e shërbimeve ,Tregun Industrial dhe tregun e fruta-pecimeve	7	8/9-vjeçar	Klasa e I	1%	32,000

Pasqyra 1.4 KLASAT E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË STRUKTURËN E

QENDRËS KULTURORE "MARGARITA TUTULANI"						
Nr	Emertimi sipas strukture	Nr. i punonjësve	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
1	Specialist muzike	1	I mesëm/muzik	Klasa VII	1%	35,400
2	Specialist metodist ,menaxher aktivitetesh	1	I mesëm/muzikë	Klasa VII	1%	35,400
3	Punonjës Ndricimi dhe Fonia	1	I Mesëm	Klasa III	1%	33,400
4	Punonjës Skene dhe Administrator godine	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
5	Animator për teatrin e kukullave	1	I mesëm	Klasa V	1%	34,500
6	Marangoz ,punëtor skene	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
7	Magaziniere ,Arkiviste ,Garderobë	1	I mesëm	Klasa IV	1%	34,100
8	Sanitare	3	I mesëm/8-9 vjeçar	Klasa I	1%	32,000
9	Roje muzeu Sinje	1	I mesëm/8-9 vjeçar	Klasa I	1%	32,000

GALERIA E ARTEVE "EDUART LEAR"						
10	Arkiviste dhe Vëzhguese në Sallë	1	I mesëm	Klasa VIII	1%	36,000
KLUBI I SHUMESPORTEVE						
11	Mirëmbajtës dhe Pastrues terreni	1	I mesëm	Klasa III	1%	33,400

Pasqyra I.5 STRUKTURA , NUMRI I PUNONJËSVE , KATEGORITE DHE KLASAT E PAGAVE TË QENDRËS "LIRA"

Nr.	Emertimi sipas strukturës	Nr. i punonjësve	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
1	Edukator /Kujdestar	4	I mesëm	VII	1%	35,400
2	Shofer	1	I mesëm/leje drejtimi D	VII	1%	35,400
3	Sanitare	2	I mesëm/8/9-viecare	I	1%	32,000

Pasqyra 1.6. KLASAT E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS NË STRUKTURËN E DREJTOR ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJËRAVE DHE SHËRBIMIT VETERINAR

Nr.	Emërtimi sipas Strukturës	Nr. i punonj	Arsimi	Klasa	Vjetërsia	Paga e grupit
1	Magaznier	1	I mesëm	Klasa IV	1%	34,100
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE TOKES DHE PYJEVE						
2	Teknik i mesëm Pyjesh	1	I mesëm/prof	Klasa V	1%	34,500
SEKTORI TEKNIK UJITJES DHE KULLIMIT						
3	Shofer Trasporti deri në 2.5 ton	2	I mesëm	Klasa III	1%	33,400
4	Teknik për ujitjen dhe kullimin	1	I mesëm	Klasa V	1%	34,500
5	Punëtor mirëmbajtës për Pyjet , ujitjen dhe kullimin	7	I mesëm/8-9 viecar	Klasa III	1%	33,400
6	Topograf	1	I mesëm	Klasa V	1%	34,500
7	Sanitare	1	I mesëm/8-9 viecar	Klasa I	1%	32,000
8	Roje nate Objektivit të Drejtorisë	1	I mesëm/8-9 viecar	Klasa I	1%	32,000
9	Roje Sezonal per pyjet	6	I mesëm/8-9 viecar	Klasa I	1%	32,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

MBI SISTEMIMIN E ZNJ. YLLKA SEITI SI RAST EMERGJENT REZIDENT PRANË QENDRES PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR “LIRA”.

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Qendra “Lira”, bazuar në kërkesen e bërë nga Znj. Suzana Rustemi e cikuar për drejtorinë e Shërbimit Social me Nr. 964 Prot, datë 17.02.2022, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” VKM-në Nr.425, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror për PAK” i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” bazuar në observimin e bërë nga Qendra “Lira” me Nr.121 Prot, datë 16.05.2022, VKB nr.94 datë 28.12.2021 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltar !

Bazuar në kërkesën e bërë nga Znj.Suzana Rustemi , në datë 17.02.2022 protokolluar për drejtorinë e Shërbimit Social me Nr. 964 Prot, drejtoria e Shërbimit Social në bashkëpunim me Qendrën “Lira” filluan punën për verifikimin dhe zbatimin e të gjitha procedurave ligjore për sistemimin e **Znj. Yllka Seiti** si person me aftësi të kufizuar në Qendrën “Lira”. Gjatë administrimit të dokumentacionit, takimit dhe vizitës në familje, mbështetur në kuadrin ligjor, rezulton se :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Familja Seiti jeton në lagjen nr. 3, “Jani Vruho” në rrugën “Baurend Xhovan Doga”, e përbërë nga 2-antarë, sipas çertifikaës të administruar nga regjistri elektronik i gjendjes civile.

Aktualisht në këtë familje jeton nëna znj. Tame Seiti e datëlindjes 23.11.1953 e cila është kryefamiljarje dhe kujdestare e vajzës znj. Yllka Seiti që trajtohet si personë me aftësi të kufizuar, e diagnostikuar me prapambetje të thellë mendore.

Znj. Yllka Seiti është diagnostikuar që në fëmijërinë e hershme me probleme të shëndetit mendor duke u hospitalizuar pranë spitalit të neurologjisë për një periudhë 1-vjeçare. Më pas, për afro një vit ka marr shërbime rezidenciale në qendrën “Zhvillimore”, pasi familjarët në atë kohë ishin të punësuar. Për gati 45 vite për znj. Yllka Seiti janë kujdesur dy prindërit, por i ati ka ndëruar jetë tetë vite më parë dhe përgjatë kësaj periudhe është dashur që znj. Tame Seiti të kujdeset e vetme për vajzën si kujdestare ligjore. Familja Seiti vazhdimisht ka bërë përpjekjet maksimale që znj. Yllka të ketë të gjithë përkujdesjen sociale dhe mjekësore.

Me kalimin e viteve znj. Tame përballlet me sëmundje të ndryshme si pasojë e moshës së madhe dhe problematikave social-ekonomike dhe shëndetësore të vajzes së saj znj. Yllka Seiti pasi është përkushtuar asaj gjatë gjithë jetës.

Për të mos mjaftuar problemet me shëndetin mendor të vajzës, në muajin Shkurt 2022 Znj. Tame pëson hemoragji cerebrale dhe paralizë. Tashmë në këtë familje ka nevojë tepër të mëdha për përkujdesin për të dy antarët.

Vajzat e tjera të znj. Tame e kanë të pa mundur të menaxhojnë këtë situatë pasi secila ka krijuar familjen e vet dhe janë të punësuar me orare të zgjatura. Të dy vajzat e zonjës kanë fëmijë të mitur për të cilët duhet të kujdesen.

Të gjendur në situatën e vëështirë sociale motra e znj. Yllka Seiti, Znj. Suzana Rustemi ka kërkuar që znj. Yllka Seiti të sistemohet si rast emergjent rezident, pranë Qendrës “Lira”.

Znj. Yllka Seiti do të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga një ekip multi-disiplinor i specializuar për personat me afësi të kufizuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bazuar në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e administruar, kërkesën e familjes, vlerësimin social-ekonomik dhe psiko-social, drejtorja e Shërbimit Social dhe Qendra “Lira” dakortësojnë që znj. Yllka Seiti të sistemohet si rast emergjent rezidente, pranë Qendrës “Lira”.

Bashkëngjitur relacionit gjeni dokumentacionin ,

1. Kërkesën.
2. Dokumentat mjekësore për znj. Tame Seiti të noterizuara.
3. Vendimin e KMCAP-it , fletë drejtimi për KEMP, epikriz përcjellse për znj. Yllka Seiti të noterizuar.
4. Observimin e Qendrës “Lira” për znj. Yllka Seiti .
5. Vërtetim Vendbnaimi .
6. Vërtetimi i të ardhurave .
7. Çertifikata të ndryshme.
8. Vërtetimi gjendjes social-ekonomike formulari tip.
9. Formular aplikimi tip.
10. Deklarata noteriale nga ana e znj. Suzana Rustemi.

DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati